

'Abdul-'Aziz Aali-Shejkh



Disa prej formave të padrejtësisë që i bëhen Gruas



سلفی

SELEFI.ORG

Kurani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Vërtet lavdia dhe falenderimi i takojnë Allahut; Atë e falenderojmë dhe prej Tij falje e ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje prej Tij nga sherri i veteve tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon, nuk ka kush ta humbasë dhe atë që Allahu e humb, nuk ka udhëzues për të përveç Allahut. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e të Pashok dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Allahu dërgoftë mbi të salavate dhe selame të shumta deri në Ditën e Gjykimit, si dhe mbi Familjen dhe Shokët e tij.

E më pas:

O ju njerëz, kijen frikë Allahun ashtu siç i duhet pasur frikë Atij. O robërit e Allahut, Islami i ka kushtuar rendit familjar një rëndësi shumë të madhe, kështu që, lidhja bashkëshortore është e bazuar në mëshirë dhe dashuri dhe Ai e ka bërë jetën bashkëshortore prehje për të dy, për burrin dhe gruan, të gjejnë prehje dhe të qetësohen me të.

Thotë Allahu i Lartësuar:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً
وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٢١﴾

“Dhe nga shenjat e Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”¹

Dhe prej rëndësisë që i është kushtuar qëndrueshmërisë së jetës bashkëshortore, është se Allahu i ka sqaruar të drejtat dhe obligimet e secilit prej bashkëshortëve kundrejt tjetrit dhe i ka urdhëruar të dy që t'i ruajnë këto të drejta.

¹ Er-Rrum, 21

وَهُنَّ مِثْلُ الَّذِي عَلَيْهِنَّ بِالْمَعْرُوفِ

“Gratë kanë aq të drejta sa kanë edhe detyra, sipas arsyes së shëndoshë.”²

Dhe është bërë obligim sjellja e mirë dhe shpërfillja e gabimeve sa më shumë të jetë e mundur. Thotë Allahu – *Xhel-le ue ‘Ala*:

وَعَاشِرُهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ

“Jetoni e silluni mirë me to.”³

Dhe thotë (Pejgamberi) – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*:

لا يفرک مؤمن مؤمنه إن کره منها خلقا رضي منها خلقا آخر

“Të mos e urrejë një besimtar një besimtare, sepse nëse nuk i pëlqen diçka tek karakteri i saj, do t’i pëlqejë diçka tjetër.”

Burri qëndron më lartë se gruaja për shkak të disa veçorive dhe karakteristikave, prej të cilave: shpenzimi për të.

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ

“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”⁴

² El-Bekare, 228

³ En-Nisa, 19

⁴ En-Nisa, 34

O ju muslimanë, vërtetë Allahu i Lartësuar e ka bërë haram padrejtësinë me të gjitha format e tij, ka bërë haram padrejtësinë me të gjitha format e tij. Thotë Allahu i Lartësuar në një hadith Kudsij:

يَا عِبَادِي إِنِّي حَرَّمْتُ الظُّلْمَ عَلَى نَفْسِي وَجَعَلْتُهُ بَيْنَكُمْ مُحَرَّمًا فَلَا تَظَالَمُوا

“O robërit e mi, Unë ia kam ndaluar Vetes Time padrejtësinë dhe ua kam ndaluar edhe juve, pra mos bëni padrejtësi.”

Dhe thotë i Dërguari – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*:

اتَّقُوا الظُّلْمَ؛ فَإِنَّهُ ظُلُمَاتٌ يَوْمَ الْقِيَامَةِ

“Frikësojuni padrejtësisë, ngase padrejtësia është errësirë Ditën e Kijametit.”

Allahu – *Xhel-le ue ‘Ala* – e ka krenuar gruan muslimane, e ka ngritur pozitën e saj dhe e ka mbrojtur prej trajtimit që i bëhej në kohën e Xhahilijetit (injurancës), nga shtypja e të drejtave të saj, nga poshtërimi dhe përrulja e saj, dhe erdhi Sheriati duke e ndaluar padrejtësinë që i bëhej asaj me të gjitha llojet e tij.

Nga format e padrejtësisë ndaj gruas, është:

Mashtrimi që i bën asaj ai që i kërkon dorën për martesë, ose ajo që ndërmjetëson për martesë, duke u paraqitur përpara saj si njeri me virtyte, me vlera, qëndrueshmëri, sjellje të mirë dhe premtime të bukura. Por, më pas, të gjitha këto dalin gënjeshtër dhe të pavërteta dhe kjo është një prej formave të padrejtësisë.

Nga format e padrejtësisë ndaj gruas, është edhe marrëdhënia e keqe me to, sjellja e ashpër ndaj tyre dhe ky është gabim nga ana e burrit.

Ka thënë Pejgamberi ynë – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*:

خيركم خيركم لأهله وأنا خيركم لأهلي

“Më i miri prej jush, është ai që është më i miri për familjen e tij dhe unë jam më i miri prej jush për familjen time.”

Ka prej robërve të Allahut që e shajnë, e mallkojnë dhe e poshtërojnë gruan për shkak se ajo është më e lartë se ai dhe kjo gjë është në kundërshtim me sheriatin e Allahut.

Kështu që, prej muslimanit kërkohet drejtësi, mirësi dhe fjalë e mirë.

وَقُلْ لِعِبَادِي يَقُولُوا الَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ الشَّيْطَانَ يَنْزَغُ بَيْنَهُمْ إِنَّ الشَّيْطَانَ كَانَ
لِلْإِنْسَانِ عَدُوًّا مُّبِينًا ﴿٥٣﴾

“Thuaju robërve të Mi që të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, shejtani mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, shejtani është armik i hapët i njeriut.” ⁵

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj gruas është: rrahja e tyre me forcë aq sa i dëmton ato, me shkak apo pa shkak.

Vërtet, Allahu ka lejuar të qëllohet gruaja vetëm pas braktisjes (në formë dënimi e edukimi) dhe këshillimit të saj, të qëllohet në mënyrë që të mos i ngelet shenjë e gjurmë tek ajo, të jetë edukuese dhe pa e dëmtuar.

Për këtë arsye Pejgamberi – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – ndaloi që gratë të rrihen dhe Umeri – *radijAllahu anhu* – tha: **“O i Dërguari i Allahut, gratë kanë marrë guxim mbi burrat e tyre.”** Kështu, Pejgameri – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – lejoi që të qëllohen dhe pas kësaj gratë e rrethuan shtëpinë e Pejgamberit duke u ankuar për burrat e tyre.

Atëherë, ai – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – tha:

⁵ El-Isra, 53

لَقَدْ طَافَ بِآلِ مُحَمَّدٍ نِسَاءٌ كَثِيرٌ يَشْكُونَ أَزْوَاجَهُنَّ ؛ لَيْسَ أَوْلَئِكَ بِخِيَارِكُمْ

“Familjen e Muhammedit e kanë rrethuar gra të cilat ankohen për burrat e tyre të cilët nuk janë më të mirë se ju.”

Pastaj tha:

لا يضرب رجل امرأة ثم يضاجعها في آخر يومها

“Mos ta qëllojë burri gruan e tij, pastaj të shkojë e të flejë me të në fund të ditës.”

Thotë A'ishah – *radijAllahu ‘anha*: “Pejgamberi – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – nuk ka qëlluar kurrë ndonjë grua dhe as shërbëtore, përveçse në xhihad në rrugë të Allahut.”

Dhe prej formave të padrejtësisë që i bëhen gruas është edhe t’i drejtohesh asaj me emrat dhe cilësitë më të shëmtuara, ngase Pejgamberi – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – ka thënë:

لا تقبّح ولا تضرب الوجه

“Mos shëmtoni dhe mos qëlloni në fytyrë.”

D.m.th. mos thoni: Allahu të shëmtoftë.

Me të vërtetë, fjala e keqe vret më shumë se vetë rrahja. Pra, nuk është mirë që t’u drejtohesh atyre me fjalë të këqija e fyese, por, drejtohu njerëzve me mirëkuptim dhe jo me ofendim e poshtërim.

Dhe prej formave të padrejtësisë është edhe mosmbajtja drejtësi midis grave në rastin kur burri ka më shumë se një grua. Ngase Allahu – *Xhel-le ue ‘Ala* – kur e bëri të lejuar martesën me më shumë se një grua, vuri si kusht përmbushjen e detyrimit, sigurimin nga padrejtësia dhe të qënurit i aftë për të mbajtur drejtësi.

Thotë Allahu – Xhel-le ue ‘Ala:

وَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تُقْسِطُوا فِي الْيَتَامَىٰ فَانكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ مَثْنَىٰ وَثُلَاثَ
وَرُبْعَ فَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تَعْدِلُوا فَوَاحِدَةً أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ ذَٰلِكَ أَدْنَىٰ أَلَّا تَعُولُوا ﴿٢﴾

“E nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimeve, atëherë, martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tre apo me katër; e, nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua ose me atë që e keni në pushtetin tuaj. Në këtë mënyrë do t’i ruheni padrejtësisë më lehtë.”⁶

Dhe ka ardhur në hadith:

مَنْ كَانَتْ لَهُ امْرَأَتَانِ فَمَالَ إِلَىٰ إِحْدَاهُمَا جَاءَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَشِقُّهُ مَائِلٌ

“Kush ka dy gra dhe anon më shumë nga njëra, do të vijë Ditën e Gjykimit me njërën anë të tij të shtrembër.”

Dhe prej llojeve të padrejtësisë ndaj gruas është gjithashtu edhe ndalimi ndonjëherë i saj që të vizitojë njerëzit e saj dhe pengimi nga takimi me prindërit, vëllezërit dhe motrat e saj me pretendimin se është e panevojshme për të.

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj saj gjithashtu, është ngarkimi i saj me diçka të cilën nuk e mban dot dhe kjo është në kundërshtim me Sunetin.

Muhammedi – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – është zotëria i bijëve të Ademit, shembulli dhe modeli i çdo muslimani dhe kur A’ishah u pyet se si ishte ai në shtëpi, tha: **“Ai i gjendej gjithmonë familjes për çdo nevojë dhe kur muezini thërriste ezanin dilte për në namaz.”**

⁶ En-Nisa, 3

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj gruas, është edhe ajo që veprojnë disa për shkak të imanit të dobët, pakësimit të turpit dhe frikës ndaj Allahut, duke e çuar atë në kundërshtimin e Sheriatit; kështu ai e imponon atë që t’ia tregojë bukurinë e saj të tjerëve, të zbulojë fytyrën dhe të përzihet me burra të cilët nuk janë prej mahremëve të saj, e ndoshta ia ka imponur asaj edhe shikimin e disa faqeve të fëlliqta e të degeneruara, të cilat nuk kanë asnjë vlerë dhe asnjë rëndësi për të. Mirëpo, atyre burrave nuk u vjen turp që t’i shohin këto pamje të këqija dhe ta detyrojnë gruan që të shohë ato pamje të panjerëzishme, të shëmtuara, të pamoralshme, të pahijshme.

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj gruas është edhe privimi që disa i bëjnë asaj prej trashëgimisë dhe ndërhyjnë në pjesën që i takon nga trashëgimia e babait, nënës apo fëmijëve të saj. E gjithë kjo vjen prej injorancës.

Me të vërtetë, Allahu – *Xhel-le ue ‘Ala* – i ka dhënë gruas të drejtën e saj në trashëgimi, i ka dhënë bashkëshortes të drejtën që të marrë një të katërtën ose një të tetën, e nëse është nënë merr një të gjashtën ose një të tretën, e nëse është bijë gjysmën, e nëse janë shumë bija marrin secila nga dy të tretat, e nëse është motër merr gjysmën ose atë që mbetet, e kështu me rradhë bëhet renditja e trashëgimisë.

Dhe Allahu kur e përfundoi çështjen e trashëgimisë, vendosi kufij dhe tha:

تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ ۚ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا
الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۚ وَذَٰلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٣﴾ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ
وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ مُهِينٌ ﴿١٤﴾

“Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut. Kush që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në Kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Kjo është fitorja e madhe. Ndërsa kush nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojnë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.” ⁷

⁷ En-Nisa, 13-14

Dhe thotë në fund të sures En-Nisa:

يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمُ أَنْ تَضِلُّوا ۖ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٧٦﴾

“Kështu Allahu ju sqaron juve, në mënyrë që të mos humbisni. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” ⁸

Pra, është obligim që t’i jepet gruas haku i saj në trashëgimi, qoftë ajo bashkëshorte, nënë, bijë, motër, ashtu siç e ka ndarë dhe e ka caktuar Allahu. Kurse ata që ndërhyjnë në pjesën që i takon asaj prej trashëgimisë, i sjellin pengesa, e kërcënojnë, e ofendojnë, e braktisin dhe nuk e duan atë derisa ajo të bëjë lëshim tek të drejtat e saj të plota dhe t’i mohojnë, e përpiqen me të gjitha mënyrat që t’i fshehin të drejtat e saj, këta i bëjnë padrejtësi veteve të tyre, këta janë keqbërësa, këta e hanë pasurinë në mënyrë të paligjshme, këta i shkelin gjykimet e Allahut.

Madje, nëse dikush beson se është gabim ose mangësi që gruaja të trashëgojë, kjo është dalje prej Islamit. E lusim Allahun të na japë paqe dhe shëndet.

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj gruas është edhe ajo që veprojnë disa duke u rënë në qafë në lidhje me shpenzimet që duhet të bëjnë për të.

Thotë Allahu – Xhel-le ue ‘Ala:

لَا تُضَارَّ وَالِدَةُ بِوَلَدِهَا وَلَا مَوْلُودٌ لَهُ بِوَلَدِهِ ۖ

“Nëna le të mos dëmtohet për shkak të fëmijës së saj e as babai të mos dëmtohet për shkak të tij.” ⁹

Dhe thotë:

⁸ En-Nisa, 176

⁹ El-Bekare, 233

أَسْكِنُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ سَكَنْتُمْ مِنْ وَجَدِكُمْ وَلَا تَضَارُّوهُنَّ لِيُضَيِّقُوا عَلَيْهِنَّ

“Gratë e ndara në periudhën e pritjes, le të banojnë aty ku banoni edhe ju, sipas mundësive tuaja dhe mos u bini në qafë për t’i detyruar (të largohen).” ¹⁰

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj saj është edhe ajo që veprojnë disa që i kërkojnë dorën për martesë një gruaje, pastaj në zemrën e tyre nuk kanë asnjë ndjenjë për të, jo për shkak se është e mangët në fenë apo moralin e saj, por sepse kur e kuptojnë se nuk ndjejnë gjë për të, atëherë përpiqen që ta lëndojnë atë në mënyrë që t’i marrë mehrin që i kishte dhënë dhe Allahu e ka ndaluar këtë gjë në Thënien e Tij:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا سَحْلٌ لَكُمْ أَنْ تَرِثُوا النِّسَاءَ كَرْهًا ^ط وَلَا تَعْضُلُوهُنَّ لِتَذْهَبُوا بِبَعْضِ مَا ءَاتَيْتُمُوهُنَّ إِلَّا أَنْ يَأْتِيَنَّ بِفَحِشَةٍ مُبَيِّنَةٍ ^ج وَعَاشِرُوهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ ^ح فَإِنْ كَرِهْتُمُوهُنَّ فَعَسَى أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَجَعَلَ اللَّهُ فِيهِ خَيْرًا كَثِيرًا ﴿١٩﴾

“O ju që besoni! Nuk ju lejohet të bëheni trashëgimtarë të grave përkundër dëshirës së tyre dhe mos i pengoni ato me qëllim që t’ua merrni një pjesë nga dhuratat që ua keni dhënë.” ¹¹

Dhe thotë:

وَإِنْ أَرَدْتُمْ اسْتِبْدَالَ زَوْجٍ مَّكَانَ زَوْجٍ وَءَاتَيْتُمْ إِحْدَهُنَّ قِنْطَارًا فَلَا تَأْخُذُوا مِنْهُ شَيْئًا ^ح أَتَأْخُذُونَهُ بِهْتِنَا وَإِنَّمَا مَبِينَا ^ط وَكَيْفَ تَأْخُذُونَهُ وَقَدْ أَفْضَىٰ بَعْضُكُمْ إِلَىٰ بَعْضٍ وَأَخَذْتُ مِنْكُمْ مِيثَاقًا غَلِيظًا ﴿٢٠﴾

¹⁰ Et-Talak, 6

¹¹ En-Nisa, 19

“Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua, duke e lëshuar njëren për të marrë një tjetër, asaj që i keni dhënë pasuri, mos i merrni nga ajo (pasuri) asgjë. A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjunah të qartë?! Dhe si do t’ia merrni asaj prapë atë (që i keni dhënë), ndërkohë që ju jeni bashkuar në një shtrat të vetëm, dhe në të njëjtën kohë ato kanë marrë prej jush besë të fortë e të sigurtë?” ¹²

Të drejtën e saj në mehr ajo e posedon kur ai hyn tek ajo (duke kryer marrëdhënie me të), kështu që, nuk i lejohet atij që ta lëndojë atë kur ajo nuk ka asnjë mangësi apo të metë në fenë dhe sjelljen e saj.

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj gruas, është të futësh hundët në pasurinë e saj personale të cilën ajo e ka fituar me punën e saj ose të ngjashme me këtë.

Kështu, disa prej tyre i bien në qafë gruas derisa t’ia marrin hakun dhe rrogën e saj. I bie në qafë bashkëshorti i saj, i bie në qafë babai i saj aq sa vendos si kusht në aktin e martesës se të gjitha rrogat e saj janë të tijat dhe se ai është administruesi i saj. E gjithë kjo është padrejtësi dhe armiqësi. Pra, pasuria që ajo ka fituar me punën e saj është haku i saj të cilën Ligjvënësi e ka ruajtur për të. Pra, nuk lejohet sulmi ndaj saj dhe as marrja e pasurisë së saj, përveçse me lejen e saj.

Ai - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* - thotë:

لَا يَحِلُّ مَالُ امْرِئٍ مُسْلِمٍ إِلَّا بِطَيِّبَةٍ مِنْ نَفْسِهِ

“Nuk është e lejuar (të merret) pasuria e muslimanit vetëm se me pëlqimin e tij.”

Dhe prej formave të padrejtësisë ndaj saj është edhe ajo që bëjnë disa që shfrytëzojnë dobësinë e gruas duke e mashtruar atë që të marrë borxhe me afat të gjatë dhe hap agjensi me emrin e saj e të tjera si këto. Kështu, ajo zhytet në borxhe! Dhe nëse ajo do të shohë sa ka arritur fitimi, atëherë do të shohë në llogarinë e saj shumë zero e asgjë tjetër!

¹² En-Nisa, 20-21

Ai e shfrytëzon dobësinë e saj në emër të bashkëpunimit, bashkëjetesës, përparimit ekonomik etj etj...derisa arrin që të marrë prej saj përfaqësinë dhe shpërdoron sa të mundet dhe si t'i dojë qejfi, padrejtësinë dhe armiqësinë e tij, pastaj e heq qafe atë duke e divorcuar ose ia mbath duke e lënë të gjithë aktivitetin në emrin e saj dhe borxhet e pashlyera në kurriz të saj. Ky njeri i ndyrë, i poshtër që nuk e ka frikë Allahun, e braktisi atë duke ia lënë mbi krye borxhet e shumta, ndërsa bankat i kërkojnë asaj të drejtën e tyre dhe e gjithë pasuria dhe rroga e saj shkon në shlyerjen e këtyre borxheve fantazmë, të cilat ia ngarkoi mbi shpinë ky bashkëshort i ndyrë.

E gjithë kjo është e kundërta e drejtësisë dhe dalje prej rrugës së Allahut. Ndërsa, drejtësia është që t'i japësh gjithësecilit hakun e tij pa i bërë zullum dhe pa armiqësi, kjo është ajo në të cilën thërret Sheriati.

Pra, është detyrë mbi të gjithë burrat që ta kenë frikë Allahun dhe të bashkëpunojnë në mirësi.

Allahu më dhëntë sukses mua dhe juve në çdo gjë që Ai do dhe kënaqet me të.

Allahu më dhëntë bereqet mua dhe juve me Kur'anin e Lartësuar, e më bëftë mua dhe juve dobi me ajetet e përkujtimin plot urtësi që gjenden në të.

I them këto fjalë dhe i kërkoj falje Allahut të Madhërishëm për vete dhe për ju dhe për të gjithë muslimanët, që të na falë çdo mëkat.

Kërkoni falje dhe pendohuni tek Ai, vërtet Ai është Falësi, i Gjithëmëshirëshmi.

Hytbeja e dytë:

E falenderojmë Allahun me falenderime të shumta, të mira, të bekuara, ashtu siç Zoti ynë do dhe kënaqet me to dhe dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e të Pashok dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, si dhe mbi Familjen dhe Shokët e tij. Allahu dërgoftë mbi të salavate të shumta deri në Ditën e Gjykimit.

E më pas:

O ju njerëz kijen frikë Allahun ashtu siç i duhet pasur frikë Atij.

O robërit e Allahut, nëse padrejtësia e burrit ndaj gruas është harram, po ashtu padrejtësi mund t'i bëjë edhe gruaja burrit të saj dhe prej atyre formave të padrejtësisë janë:

Disa gra, Allahu na udhëzoftë neve dhe ato në Rrugën e Drejtë, ngrihen mbi burrat e tyre dhe mburren para tyre, ose për shkak të kualifikimit më të lartë se ai në dije ose për shkak se është më e pasur se ai ose ka një rang shoqëror më të lartë se burri i saj ose familja e saj ka një pozitë shoqërore më të lartë se burri i saj, e duke u nisur prej kësaj e ofendon atë dhe sillet me arrogancë e mendjemadhësi para tij dhe e harron Fjalën e Allahut:

وَاللرِّجَالِ عَلَيْهِنَ دَرَجَةٌ ۖ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

“Ndonëse burrat kanë një shkallë (më shumë përgjegjësie) mbi ato. Dhe Allahu është i Gjithëfuqishëm, Më i Urti Gjithëgjykues.”¹³

¹³ El-Bekare, 228

Dhe prej padrejtësisë së disa grave është edhe egoizmi dhe kushtimi rëndësi vetëm veteve të tyre pa e vrarë mendjen për burrin, gjendjen dhe çështjet e tij.

Po ashtu, prej padrejtësisë është edhe mosqëndrimi në shtëpi, daljet e shpeshta nëpër tregje, vonimi në to ndërsa shtëpia është bosh, nuk ka kush ta drejtojë, nuk ka kush ta rregullojë, nuk ka kush t'i marrë përsipër problemet e saj dhe gjendja e burrit është e përhumbur.

Gjithashtu, prej padrejtësisë është edhe kur ajo e lë atë pas dore në lidhje me çështjet e tij personale duke e lënë atë nën përgjegjësinë e shërbëtores apo dikujt tjetër, pastaj vijnë fatkeqësitë dhe belatë dhe shohim se cilat janë arsyet?

Me të vërtetë, ajo është grua që nuk i jep hakun burrit të saj, e cila nuk e vret mendjen për të dhe që nuk e çon në vend kujdesin e duhur ndaj burrit, ngase ajo është kujdestare dhe përgjegjëse për familjen e saj. Dhe burri, fëmijët dhe shtëpia e saj janë amanet për të.

Gruaja e mirë e nxit burrin e saj në mbajtjen e lidhjeve farefisnore, në bamirësi ndaj nënës dhe babait të tij, në bamirësi ndaj fqinjëve dhe sjelljen e mirë me ta.

Ndërsa grua e keqe e nxit burrin e saj në shkëputjen e lidhjeve me prindërit e tij dhe mosmirënjohjen ndaj tyre, si dhe në shkëputjen e lidhjeve farefisnore.

Gruaja e mirë është e duruar me burrin e saj dhe kujdeset për çështjet e tij personale, nuk e ngarkon atë përtej mundësisë së tij dhe nuk e ngarkon atë me shpenzime nëse ai nuk i përballon dot ato, përkundrazi i merr parasysh rrethanat në të cilat ndodhet dhe jeton me të në ndershmëri, sinqeritet dhe besnikëri, nuk flet lart e poshtë e as nuk i nxjerr të metat e tij, por ajo përmirëson, rregullon, paqëson dhe kërkon ndihmë prej Allahut.

Mirësia më e madhe që ka muslimani është grua e mirë, nëse e sheh, gëzohet, nëse e urdhëron, bindet e nëse largohet prej tij, e ruan atë në veten e saj dhe pasurinë e tij.

فَالصَّلَاةُ قَنْتَتُ حَفِظْتُ لِلْغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ

“Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu.”¹⁴

Pra, gruaja muslimane duhet t'i frikësohet Allahut në lidhje me burrin e saj dhe të kujdeset dhe ta ruajë shtëpinë e saj, t'i kushtojë rëndësi burrit të saj dhe përgjegjësisë që ka ajo, ngase ajo e ka amanet dhe Allahu do ta pyesë atë për këtë gjë.

Dijeni – Allahu ju mëshiroftë – se fjala më e mirë është Libri i Allahut dhe se udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – dhe punët më të këqija janë ato të shpikurat dhe se çdo bidat është humbje. Dhe e keni detyrë të kapeni pas Xhematit të muslimanëve, ngase Dora e Allahut është me Xhematin dhe kush ndahet nga Xhemati, përfundon në Zjarr.

Dërgoni salavate mbi Muhamedin – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – duke ndjekur urdhërin e Zotit tuaj – Allahu ju mëshiroftë.

Thotë i Lartësuari:

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا

تَسْلِيمًا

“Vërtet, Allahu dhe engjëjt e Tij dërgojnë salavate mbi Pejgamberin. O ju që besoni, dërgoni salavate dhe selame mbi atë.”¹⁵

O Allah, dërgo salavate dhe selame dhe bekoje robin dhe të Dërguarin Tënd, Muhamedin.

¹⁴ En-Nisa, 34

¹⁵ El-Ahzab, 56

O Allah, qofsh i kënaqur nga Khalifët Udhëzues, Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu, nga të gjithë Shokët e Pejgamberit Tënd, nga Tabi'inët dhe nga ata që i ndoqën me mirësi deri në Ditën e Gjykimit, si dhe nga ne bashkë me ata, me Faljen Tënde, me Bujarinë Tënde, me Mirësinë Tënde, o më i Mëshirëshmi i mëshiruesve.

O Allah, jepi krenari Islamit dhe Muslimanëve, përulë shirkun dhe mushrikët, shkatërroi armiqtë e Fesë, ngadhënjeji robërit e Tu që të veçojnë Ty në adhurim.

O Allah, jepi këtij vendi (Mbretërisë së Arabisë Saudite) siguri dhe qetësi, si dhe të gjitha vendeve të Muslimanëve, o Zot i Botëve.

O Allah na jep siguri në vendet tona. O Allah, na jep siguri në vendet tona. O Allah, na jep siguri në vendet tona dhe përmirësoji prijësit dhe udhëheqësit tanë. O Allah, jepu sukses atyre në çdo gjë që është në të mirën e Islamit dhe muslimanëve.

O Allah, jepi sukses në çdo gjë të mirë prijësit tonë, prijësit të Muslimanëve, ‘Abdullah bin ‘Abdul‘Aziz.¹⁶ O Allah, ndihmoje dhe mbroje në çdo gjë që e brengos atë. O Allah, jepi bereqet atij në popullin e tij dhe në të gjithë shoqërinë Islame. O Allah, jepi atij suksesin Tënd, mbrojtjen Tënde, ndihmën Tënde, me të vërtetë Ti je i Plotfuqishëm për gjithçka.

O Allah, jepi sukses në çdo gjë të mirë pretenditit të kurorës, Sultan bin ‘Abdul‘Aziz¹⁷ dhe drejtoje atë në fjalët dhe veprat e tij.

O Allah, jepi sukses në çdo gjë të mirë zëvendësit të dytë, Naif bin ‘Abdul‘Aziz¹⁸ dhe ndihmoje atë në detyrën e tij dhe bëji të gjithë ata udhëheqës të udhëzimit, të qeverisjes dhe mirësisë, me të vërtetë Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë.

O Allah, ndaloje derdhjen e gjakut të Muslimanëve dhe bashkoje fjalën e tyre në bindjen ndaj teje. O Allah, ruaji ata prej kurtheve të kurthngritësve dhe zilisë së ziliqarëve.

¹⁶ **Sh.p:** Kjo Hutbe është mbajtur kur mbreti ‘Abdullah bin ‘Abdul‘Aziz ishte gjallë. Mbreti – Allahu e mëshiroftë – vdiq në Janar të vitit 2015.

¹⁷ **Sh.p:** Pretendenti i kurorës Sultan bin ‘Abdul‘Aziz – Allahu e mëshiroftë – vdiq në Tetor të vitit 2011.

¹⁸ **Sh.p:** Zëvendësi i dytë i kurorës, Naif bin ‘Abdul‘Aziz – Allahu e mëshiroftë – vdiq në Qershor të vitit 2012.

O Allah jepu atyre sukses që të kthehen tek ajo që është e saktë, vërtet Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë.

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ
ءَامَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿١٩﴾

“Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë ndonjë të keqe ndaj besimtarëve. O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë.” ¹⁹

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٢٠﴾

“Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjunah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, vërtet që do të jemi nga të humburit.” ²⁰

O Allah ti je i Adhuruari, përpos të Cilit askush nuk e meriton adhurimin, Ti je i Pasuri dhe ne jemi të varfërit, dërgo mbi ne shi dhe na jep me të fuqi që të të bindemi Ty dhe bëje atë të zgjasë.

O Allah ti je i Adhuruari, përpos të Cilit askush nuk e meriton adhurimin, Ti je i Pasuri dhe ne jemi të varfërit, dërgo mbi ne shi dhe na jep me të fuqi që të të bindemi Ty dhe bëje atë të zgjasë.

O Allah na sill shi, o Allah na sill shi, o Allah na sill shi.

O Allah na vadit me shi si mëshirë dhe jo si bela, as shkatërrim e as përmbytje.

¹⁹ El-Hashr, 10

²⁰ El-Araf, 23

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿٢٠١﴾

“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit.” ²¹

O robërit e Allahut:

﴿ إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايَ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴾ ﴿٢٠٢﴾

“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin.” ²²

Pra, kujtojeni Allahun e Madhëruar, që Ai t’ju kujtojë juve dhe falenderojeni Atë për të gjitha mirësitë që u ka dhënë, në mënyrë që t’ua shtojë ato. Vërtet, përkujtimi i Allahut është më i madhi dhe Allahu e di se çfarë veproni.

Përktheu: Umm ‘Akil



²¹ El-Bekareh, 201

²² En-Nahl, 90